STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 18 nëntor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE SHTETI DO TE ZGJEROJE PROGRAMIN E BLERJES PER PRONARET E SHTEPIVE TE STEJTEN AJLEND (STATEN ISLAND) TE PREKUR NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY)

Pronarët e shtëpive në Oshean Briz (Ocean Breeze) tani kualifikohen për blerje sipas Programeve të Rimëkëmbjes së Ngritjes së Shtëpive në NY

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se pronarët e shtëpive në lagjen Oshean Briz (Ocean Breeze) në Stejtën Ajlënd (Staten Island) tani do të kualifikohen për ndihmën e blerjes sipas Programeve të Rimëkëmbjes së Ngritjes së Shtëpive në NY. Sipas programit të blerjes, pronat e blera do të mirëmbahen si hapësirë e hapur ose do të transformohen në zona të mbrojtjes bregdetare, parqe ose përdorime të tjera jo të banimit që do të ndihmojnë në mbrojtjen e komuniteteve aty pranë nga ndikimi i motit ekstrem. Me njoftimin e sotëm, deri në 129 prona në Oshean Briz (Ocean Breeze) tani do të kualifikohen për blerje (harta e lagjes me pronat që kualifikohen është e disponueshme këtu). Pjesëmarrja në program është krejtësisht vullnetare dhe zyrtarë të shtetit ishin të pranishëm në veprimtarinë e sotme për të ndihmuar që pronarët e interesuar të shtëpive të bëjnë kërkesë për programin.

“Pronarët e shtëpive dhe bizneset në Stejtën Ajlënd (Staten Island) e pësuan nga shkatërrimi dhe dëmtimi më i madh në Shtetin e Nju Jorkut (New York State) si rezultat i super stuhisë Sendi (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Realiteti është se moti ekstrem është duke ndodhur më shpesh dhe duhet të ndjekim një metodë të re, më të zgjuar në rindërtimin e komuniteteve tona në zonat e prira për dëmtim nga stuhia. Duke zgjeruar programin e shtetit ndaj pronarëve të shtëpive në Oshean Briz (Ocean Breeze), jemi duke u dhënë banorëve një mundësi për t’u larguar nga një zonë që mund të goditet përsëri nga një stuhi në të ardhmen dhe të rifillojnë jetën pa frikën e shkatërrimit në të ardhmen si rezultat i motit ekstrem.”

Seth Dajmënd (Seth Diamond), Drejtor i Zyrës për Rimëkëmbjen nga Stuhia, tha: “Zona e përmirësuar e blerjes u jep pronarëve të shtëpive një mundësi për një fillim të ri pas përmbytjeve të përsëritura dhe lejon që Shteti (State) të mbrojë më mirë komunitetet aty pranë.”

Zona e përmirësuar e blerjes u përcaktuar mbështetur në historinë e dëmit të shkaktuar nga ngjarje të motit ekstrem, interesat e përgjithshme të pronarëve të shtëpive në pronat pranë fushës së përmbytjes dhe marrëveshjes ndërmjet zyrtarëve të bashkive. Prona blihet me Vlerën e Drejtë të Tregut përpara stuhisë dhe pronarëve të shtëpive u ofrohen pagesa të stimujve për t'u rivendosur brenda pesë qarqeve. Fondet do të vihen në dispozicion nëpërmjet programit të Fondeve në Bllok për Rimëkëmbjen nga Katastrofa dhe Zhvillimin e Komunitetit (CDBG-DR) të Shtetit (State), të financuar nga Departamenti i Strehimit & Zhvillimit Urban i SH.B.A.-së.

Programi i Blerjes së Ngritjes së Shtëpisë së NY filloi në prill 2013 dhe tani përfshin 613 prona në Qarkun Safolk (Suffolk), Long Ajlënd (Long Island) si dhe 420 prona në Okud Biç (Oakwood Beach), Stejtën Ajlënd (Staten Island). Programi i blerjes në Okud Biç (Oakwood Beach) tashmë përfshin 312 pronarë të shtëpive.

Senatori Endrju Lanza (Andrew Lanza) tha, "Programi i blerjes i shtetit është një mundësi e rëndësishme për banorët e prekur të Oshean Briz (Ocean Breeze) që të kenë me të vërtetë një fillim të ri. Zgjerimi i zonës së mbulimit për të përfshirë këta banorë shtesë jeta e të cilëve u kthye me kokë poshtë ishte një hap logjik ndërsa vazhdojmë të ndërtojmë në mënyrë më të zgjuar, më të fortë dhe më të sigurtë sesa më parë. Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen e tij dhe që përsëri u ngrit në këmbë për banorët e Stejtën Ajlënd (Staten Island) dhe për t'u siguruar se dollarët e ndihmës të Sendit (Sandy) shkojnë drejtpërdrejt tek viktimat e stuhisë si dhe për të ndihmuar që Stejtën Ajlënd (Staten Island) të bashkojë përsëri copat."

Anëtari i Asamblesë Majkëll Kusik (Michael Cusick) tha, "Programi i blerjes së shtëpive përfaqëson metodën e Guvernatorit Kuomo (Cuomo) ndaj një strategjie më të zgjuar, afat-gjatë, të përqëndruar për rimëkëmbjen nga stuhia. Ndërsa mund t'i rindërtonim këto shtëpi këtu në Oshean Briz (Ocean Breeze), realiteti është se jemi duke përjetuar mot gjithnjë e më ekstrem dhe kjo lagje është në rrezik që të goditet përsëri rëndë nga një stuhi tjetër. Lënia e lagjes së dikujt është e vështirë, por duke ofruar të mbulojë vlerën e plotë të këtyre shtëpive, shteti është duke u dhënë pronarëve të shtëpive një mundësi të vërtetë për të rindërtuar jetën e tyre pa frikë nga Sendi (Sandy) i ardhshëm. Falënderoj Guvernatorin që është këtu sot për të vazhduar punën e tij për të ndihmuar rimëkëmbjen këtu në Stejtën Aljënd (Staten Island)."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian